



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 6, datë 30.01.2026

PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ANËTARËVE EKZEKUTIVË TË KËSHILLIT
TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “WVP FUND MANAGEMENT TIRANA”
SH.A.-SHOQËRI ADMINISTRUESE E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE
KOLEKTIVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Arton Lena si anëtar ekzekutiv i Këshillit të Administrimit, në pozicionin e administratorit dhe zj. Arjola Shegani si anëtare ekzekutive e Këshillit të Administrimit, në pozicionin e zv.administratorit të shoqërisë “WVP Fund Management Tirana” sh.a.-Shoqëri Administruese e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive për një periudhë 3 vjeçare, deri në datë 24.01.2029.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Adela XHEMALI